

Data 10.10.2023

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Karburant (Gazoil (10ppm))” -Marrëveshje Kuadër - me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 12 muaj.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Karburante 09100000-0

Karburant diesel 09134100-8

VLERA E FONDIT LIMIT: 22,249,991.41 (njëzet e dy milion e dyqind e dyzet e nëntë mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e një presje dyzet e një) **Lekë pa tvsh.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,autoriteti kontraktor NMIPP, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8.*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP i ndryshuar, nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën, duhet të paraqesin kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare 2020,2021 dhe 2022 në një vlerë jo më të vogël se vlera e fondit limit/vlera e pritshme të MK, lëshuar nga autoriteti përkatës. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi:Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43 pika 2 germa b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Vlera e xhiros se përcaktuar dhe te kerkuar nga autoriteti kontraktor kerkohet për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike te operatorit ekonomik si dhe per të vendosur kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në legjislacioni tatimor ku xhiroja dhe bilancet kane si afat perfundimtar per tu mbyllur dhe dorezuar prane organeve tatimore maksimumi deri ne fund te muajit Prill te vitit qe vjen.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë sipas ligjit nr.8438 date 28.12.1998 i ndryshuar.(Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen afatet për paraqitjen nga tatimpaguesit të deklaratës vjetore pranë organeve tatimore).

2.2.2.Operatori Ekonomik duhet te kete nje aktivitet pozitiv te qendrueshem gjate 3(tre) viteve te fundit 2020, 2021 dhe 2022. *Per te vertetuar plotesimin e ketij kushti Operatori Ekonomik duhet te paraqese kopje të bilanceve të 3 (tre) viteve të fundit, të paraqitur pranë autoritetit përkatëse, të konfirmuara nga ky autoritet, ne te cilat duhet te rezultoje se nuk ka dale me humbje te pakten ne dy vitet e njepasnjeshem.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43,pika 4,të VKM nr.285,datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në Ligjin nr.9920 date 19.05.2008 ”Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe aktet nënligjore ne zbatim te tij.

2.2.3 Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2022 dhe viti 2023, ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas përcaktimeve të Ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, (i ndryshuar). Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga autoriteti përkatës në të cilin është regjistruar sipas QKB.

***Shënim:** Ky kriter (2.2.3) do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8, të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t’u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.*

***Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar sipas Nenit 76 pika 2 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”; Kreut V, Seksioni III, Nenin 43, pika 6 të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” si dhe sipas ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” (i ndryshuar), ku në zbatim të legjislacionit në fuqi, Qendra Kombëtare e Biznesit ka funksion të mbajë regjistrin tregtar dhe për qëllim të regjistrimit fiskal, në të cilin përcaktohen dhe vendet e ushtrimit të operatorëve ekonomikë, duke qënë se këto të fundit kanë detyrimin të paguajnë të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në vendet që ushtrojnë aktivitetin e tyre, atëherë operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se i kanë likuiduar këto detyrime nëpërmjet paraqitjes së vërtetimit të lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore.*

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi nga operatori ekonomik për furnizime të mëparshme të ngjashme në një vlerë jo më të vogël se 40% të fondit limit/vlera e pritshme të MK, **për të cilin konkurren operatori dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.**

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik ose fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara, ose
- b) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

***Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 40, pika 4, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën,*

prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë ne vlerën jo më të vogël se 40% të fondit limit/vlera e pritshme të MK, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë ne vlerën jo më të vogël se 40% të fondit limit/vlera e pritshme të MK, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin 40, pika 4 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” e ndryshuar.

2.3.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë Lejën e Tregëtimit të Karburanteve në përputhje me Ligjin Nr. 8450, date 24.02.1999 “Për përpunimin, transportin dhe tregëtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, te ndryshuar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 2 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 40, pika 5, gërma ”a”, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, në ligjin nr.8450, datë 24.2.1999, ”Per përpunimin, transportimin dhe tregëtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar, si dhe VKM nr.970, datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregëtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale për furnizimin e mallrave, objekti i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore, pasi kjo është një procedurë shumë specifike, vetëm për blerje karburanti, lëndë djegëse për automjete Diesel (Gazoil), e cila kërkon leje të veçantë për tregëtimin me pakicë të këtij malli.

2.3.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë flete/raport analizat e furnizimit të fundit para zhdoganimitose raport-analiza të lëshuara nga autoritetet përkatëse (jo më parë se 6 muaj nga data e hapjes së ofertave), të bëra nga laboratorit i ISHTI-it për Artikullin **Gazoil (10 ppm ULSD)** në përputhje me standartet shqiptare, shoqëruar me certifikatën e origjinës dhe cilësisë së mallit.

Argumentimi:Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se ofertojnë mallra të cilët përmbushin standartet teknike dhe autoriteti kontraktor kërkon të bëjë një vlerësim sa më korrekt dhe të saktë të mallrave që do të prokurohen, që të jenë në përputhje me specifikimet e kërkuara.

2.3.4 Operatori ekonomik ofertues duhet të garantojë furnizimin me karburant sipas standarteve shtetërore në fuqi Diesel10 PPM, në përputhje me standardin shtetëror S.SH/EN 590:2013+A1:2017 ose ekuivalente me te, si dhe te disponoje te pakten 2 (dy) pika shitje karburanti (me shërbim, çdo ditë të javës), duke i vertetur me nje nga format e disponimit sipas Kodit Civil (kontrate noteriale ose akt proniesie ose te jene te pasqyruara ne ekstraktin e QKB, etj) nga te cilat 1 (nje) pike të stacioneve te shitjes se karburanteve brenda territorit te qytetit te Pogradecit, si dhe te disponoje ose te kete kontrate sherbimi me 1 (nje) pike tjeter shitje ne Zonen e Mokres.Per disponimin e stacionit ne Zonen e Mokres me ane te kontrates se sherbimit duhet te paraqese kontrate sherbimi noteriale, e vlefshme aq kohe sa zgjat Marreveshja Kuader.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40, pika 6, gërma ”c”, dhe neni 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, në ligjin nr. 10433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Rrepublicën e Shqipërisë”, si dhe ligjit nr. 8450, datë 24.02.1999 “Për përpunimin, për transportin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se ofron produktin me cilësi duke respektuar standartet Ligjore. Vërtetim i lëshuar nga ky institucion siguron Autoritetin Kontraktor që ofrohet furnizim me karburant cilësor si dhe operatori ekonomik ofertues zbaton kushtet e parashikuara në lejet apo autorizimet përkatëse për ushtrimin e aktivitetit.

Duke qene se automjetet ne pronesi te NMIPP jane te angazhuara ne pune kryesisht ne Zonen e Mokres e cila eshte Njesia me e larget e Bashkise Pogradec, kerkohet nje pike furnizimi per mjetet ne kete zone, e cila do te ule kostot e transportit per mjetet. Karburanti perdoret kryesisht per mjetet e pune si fadroma, eskavatore, qe punojne me shume ne Zonen e Mokres eshte e nevojshme furnizimi me karburant ne Zonen e Mokres pasi do te shkurtonte kohe dhe do te ulte shpenzimet e transportit te mjeteve deri ne qytet per tu furnizuar me karburant.

2.3.5 Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të jetë i pajisur me autobot të posaçëm për transport karburanti së bashku me aparatën matës.

2.3.5.1 Në rastin kur O.E e ka në pronesi duhet të paraqesë të:

- Lejë qarkullimi e vlefshme.
- Polica e sigurimit e vlefshme.
- Certifikatë për transport mallrash të rrezikshme, lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor.
- Foto të mjetit dhe autobotit të posaçëm.

2.3.5.2 Kur mjeti është me qira/ ose huapërdorje duhet të paraqesë :

- Kontrate noteriale qeraje/huapërdorje objekt i këtij prokurimi dhe e vlefshme për periudhën e furnizimit.
- Lejë qarkullimi e vlefshme
- Polica e sigurimit e vlefshme
- Foto të mjetit dhe autobotit të posaçëm.
- Certifikatë për transport mallrash të rrezikshme, lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor.

Ofertuesi i kualifikuar i pari duhet të dorëzojë përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe brenda afatit të përcaktuar në kërkesën për dorëzim dokumentacioni pranë AK, dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të parashikuara në pikën 2 të nenit 26 të VKM-se 285 date 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40, pika 5, gërma ”ç”, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, ky kriter është shumë i domosdoshëm për që një operator ekonomik të kualifikohet në një procedurë prokurimi dhe të lidhe kontratën, pasi duhet të zotërojë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, **makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike**, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

Per sa me sipër, argumentojmë se për furnizimin e kaldajave në institucionet shkollore, objekt prokurimi, nevojitet të paktën 1 autobus të posaçëm për transportin e karburantit në institucionet e përcaktuara nga AK.

2.3.6 Operoret ekonomikë pjesëmarrës duhet të paraqesin deklaratat si më poshtë:

- Subjekti duhet të deklarojë se merr përsipër furnizimin me karburant detyrimisht në pistoletë publike. *(Deklaratë nga subjekti ofetues.)*
- Subjekti duhet të deklarojë, se merr përsipër furnizimin me karburant me mjetin e tij (bot) dhe shpenzimet e tij me shërbim 24 orë në kaldajat e Shkollave, sipas kërkesave të tij dhe se boti i paraqitur në prokurim do të jetë ai me të cilin do të kryhet furnizimi i kaldajave të shkollave. *(Deklaratë nga subjekti ofetues)*
- Subjekti duhet të deklarojë se merr përsipër që kartat elektronike duhet të jenë pa skadencë, deri në përfundim të të gjithë sasise të karburantit.
- Operatori ekonomik duhet të mbulojë furnizimin nëpërmjet kartave elektronike të personalizuar, sipas adresave të kërkuara nga Autoriteti Kontraktor. *(Deklaratë nga subjekti ofetues)*.
- Subjekti të deklarojë se faqja e menaxhimit të karburanteve (webpage) do të ofrojë shërbimin e ngarkimit të sasise të karburantit nga Operatori ekonomik drejt Autoritetit Kontraktor, me qëllim që rimbushja e kartave elektronike të personalizuar me targonë e mjetit si dhe administrimi i sasise të karburanteve të kryhet nga vet Autoriteti kontraktor.
- Subjekti të deklarojë se faqja e menaxhimit të karburanteve do të ofrojë edhe shërbimin për krijimin e strukture piramidale në përputhje me strukturën piramidale të Autoritetit kontraktor, shërbimin e furnizimit me karburant nëpërmjet kartave elektronike, të cilat ngjiten në xhamin e automjetit dhe ofrojnë shërbimin e furnizimit me karburant vetëm për atë automjet për të eliminuar levizjen e mundshme të targave nga mjetit të shoqërisë drejt mjeteve private.

- Mos ofrimi i shërbimeve të kërkuara me siper në mënyrë elektronike nëpërmjet Faqes së menaxhimit të karburanteve (webpage), që ofron cdo operator ekonomik pjesëmarrës përben kusht për s'kualifikim.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40, pika 5, gërma ”ç”, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, si dhe në VKM nr. 561, datë 29.07.2016, “Për Standartizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve të karburantit në njesite e qeverisjes së përgjithshme”.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë me anë të vetdeklarimit se ofron një faqe për menaxhimin e karburanteve, në mënyrë që të ofrojë shërbimin e ngarkimit/transferimit të sasisë së karburantit nga Operatori ekonomik drejt Autoritetit kontraktor me kartë elektronike.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Argumentim: Specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, janë hartuar në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, të ndryshuar, në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 147, datë 21.03.2007, “Për cilësinë e lëndës djegëse, diesel” dhe standardeve shtetërore në fuqi. Për këtë objekt prokurimi autoriteti kontraktor ka përdorur specifikimet teknike duke ju referuar standardeve kombëtare, të marra nga Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimeve.

Kërkesat e mësipërme janë në përpjestim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, duke shërbyer për autoritetin kontraktor për njohjen e kapaciteteve teknike dhe profesionale të operatorëve ekonomik dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

NJËSIA E PROKURIMIT: